

GJYKATA E APELIT GOSTIVAR



RAPORTI VJETOR



Zhivko Brajkoski 1

info@asgostivar.mk

042/221-544

2021

PËRMBAJTJA

| | | |
|-------|--|-----------|
| I. | PUNA AKTUALE NË NIVEL TË GJYKATËS | 3 |
| II. | ADMINISTRIMI I GJYKATËS | 4 |
| III. | KUALITETI I PUNËS NË NIVEL TË GJYKATËS | 5 |
| IV. | PUNA E LËNDËVE NË NIVEL TË SEKTORVE : | |
| | A) SEKSIONI PENAL | 5 |
| | B) SEKSIONI CIVIL | 7 |
| V. | KUALITETI I LËNDËVE NË NIVEL TË SEKTORËVE: | |
| | A) SEKSIONI PENAL | 9 |
| | B) SEKSIONI CIVIL | 10 |
| VI. | GJENDJA E LËNDËVE TË VJETRA | 11 |
| VII. | RAPORTI MBI TEKNOLOGJINË INFORMATIVE | 11 |
| VIII. | RAPORTI MBI KAPACITETET HAPSINORE DHE RESURSET NJERËZORE: | |
| | A) KAPACITETET HAPËSIONRE | 12 |
| | B) RESURSET NJERËZORE | 14 |

1. PUNA AKTUALE NË NIVEL TË GJYKATËS

Gjykata e Apelit në Gostivar si organ i pavarur shtetëror gjykon mbi bazë të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut, mbi ligjet dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara në pajtim me Kushtetutën, me çka siguron aplikimin e të drejtës dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut.

Gjatë periudhës raportuese, gjykata me angazhimin maksimal profesional të të gjithë të punësuarve – gjykatësve, kuadrit profesional dhe personelit administrativ-teknik, mbetën të dedikuar në përpjekjet për kryerjen efikase dhe kualitative të detyrës gjyqësore, në korniza të kompetencave të saj me angazhimin maksimal dhe realizimin e programit për punë për vitin 2021.

Në këtë periudhë gjykata gjithsej në punë ka pasur 3.870 lëndë, numër të cilin e përbëjnë 471 lëndë të përcjella si lëndë të pambaruara nga periudha raportuese e mëparshme dhe 3.399 lëndë të reja.

Domethënë, vëllimi i punës në krahasim me vitin e kaluar, kur numri i lëndëve shkoi deri në 2.923 u zvoglua për 476 lëndë që gjithsej janë 3.399.

Gjatë periudhës raportuese nga numri i përgjithshëm i lëndëve në punë, gjykata përfundoi 3.207 lëndë, që paraqesin rritje prej 417 lëndë në lidhje me vitin e kaluar, kështu që për në fund të vitit raportues kanë ngelur 663 lëndë të pa zgjidhura.

Sipas të dhënave statistikore numri i lëndëve në periudhën raportuese në krahasim me vitin 2020 në **sektorin penal** është konstatuar zmadhim i numrit të përgjithshëm të lëndëve për 112 lëndë. Vëllimi i lëndëve është rritur në regjistrat "KZH", "KSZH" dhe "KR" edhe atë në "KZH" për 84 lëndë, ndërsa në "KSZH" për 4 lëndë dhe në regjistrin "KR" për 19 lëndë, ndërsa në regjistrin tjerë ka ulje të vëllimit të lëndëve edhe atë në regjistrin "KZHM" për 4, ndërsa në regjistrin "PRKZH" për 30 lëndë. Në **sektorin civil** në periudhën raportuese ka rritje të vëllimit për 364 lëndë në krahasim me vitin 2020. Vëllimi i lëndëve është rritur në regjistrin "GZH", "ROZH" dhe "R" edhe atë në regjistrat "GZH" për 180 lëndë, në regjistrin "ROZH" për 202 lëndë dhe në regjistrin "R" për 4 lëndë, ndërsa në regjistrin "TSZH" vërehet rënie prej 22 lëndë në krahasim me vitin e kaluar.

Situata në lidhje me kohëzgjatjen e procedurës është si më poshtë:

- **Deri në 1 muaj**, 1,239 raste ose 38.63% janë zgjidhur,
- **Nga 1-3 muaj**, janë zgjidhur 965 raste ose 30.09%,
- **Nga 3-6 muaj**, janë zgjidhur 812 raste ose 25.32%,
- **Gjatë 6 muajve**, 191 raste ose 5.96% u zgjidhën.

Puna e lëndëve në nivel të gjykatës

| Regjistri | Lëndë të pazgjedhura nga fillimi i vitit | Lëndë të reja të pranuar | Lëndë përsëri në punë | Të regjistruara gabimish | Gjithësej lëndë në punë | Lëndë të zgjidhura | Lëndë të pazgjidhura |
|------------------|--|--------------------------|-----------------------|--------------------------|-------------------------|--------------------|----------------------|
| KZH | 153 | 530 | 0 | 0 | 683 | 505 | 178 |
| KZHM | 2 | 10 | 0 | 0 | 12 | 10 | 2 |
| KSZH | 11 | 187 | 0 | 0 | 198 | 198 | 0 |
| PRKZH | 20 | 539 | 0 | 0 | 559 | 558 | 1 |
| KR | 1 | 59 | 0 | 0 | 60 | 60 | 0 |
| GZH | 191 | 1175 | 0 | 0 | 1366 | 1079 | 287 |
| ROZH | 54 | 724 | 0 | 0 | 778 | 621 | 157 |
| TSZH | 39 | 150 | 0 | 0 | 189 | 151 | 38 |
| R | 0 | 25 | 0 | 0 | 25 | 25 | 0 |
| GJITHËSEJ | 471 | 3.399 | 0 | 0 | 3.870 | 3.207 | 663 |

2. ADMINISTRIMI I GJYKATËS

Në lidhje me administratën gjyqësore, vëllimi i lëndëve të reja në periudhën raportuese është 1.324 lëndë, që shënon rritje për 189 lëndë në krahasim me vitin e kaluar.

Nga ata 1202 lëndë janë të regjistrimit "SU"-regjistri për administratën gjyqësore, 11 lëndë janë nga regjistri "SU-DOV"- regjistri konfidencial i administratës gjyqësore, 25 lëndë janë nga regjistri "UPP"- regjistri për evidencë të parashtrësive dhe ankesave, 78 lëndë janë nga regjistri "IZZ"- regjistri për largimin e gjykatësve ose kryetarit dhe 8 lëndë janë të regjistrimit "SPI"- regjistri për qasje të lirë deri te informatat.

Në periudhën raportuese të gjitha lëndët e administratës gjyqësore janë kryer.

| Regjistri | Lëndë të pazgjedhura në fillim të vitit | Lëndë të reja të pranuar | Gabimisht të regjistruara | Gjithsej lëndë në punë | Lëndë të zgjedhura | Lëndë të pazgjedhura |
|------------------|---|--------------------------|---------------------------|------------------------|--------------------|----------------------|
| SU | 0 | 1202 | 0 | 1202 | 1202 | 0 |
| SU-DOV | 0 | 11 | 0 | 11 | 11 | 0 |
| SU-STR-DOV | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| UPP | 0 | 25 | 0 | 25 | 25 | 0 |
| IZZ | 0 | 78 | 0 | 78 | 78 | 0 |
| SPI | 0 | 8 | 0 | 8 | 8 | 0 |
| GJITHËSEJ | 0 | 1.324 | 0 | 1.324 | 1.324 | 0 |

3. CILËSIA E PUNËS NË NIVEL TË GJYKATËS

Sipas të dhënave nga lëndët e kthyer nga Gjykata Supreme, gjykata ka mbajtur kualitetin e lartë të punës.

Gjegjësisht janë kthyer gjithsej 132 lëndë, nga të cilat **të vërtetuara** 96 vendime apo 2,99 % nga gjithsej lëndët e zgjidhura, janë **ndryshuar** 8 vendime apo 0,25 % nga gjithsej lëndët e zgjidhura, dhe janë **anuluara** 28 lëndë apo 0,87 % nga gjitha lëndët e zgjidhura.

| Lëndë të zgjidhura | Të vërtetuara | | Anuluara | | Të ndryshuara | |
|--------------------|---------------|-------|----------|-------|---------------|-------|
| Numër | Numër | % | Numër | % | Numër | % |
| 3.207 | 96 | 2,99% | 28 | 0,87% | 8 | 0,25% |

Në lidhje me përqindjen e vendimeve të kthyer nga Gjykata Supreme janë vërtetuar 72,73 % nga numri i lëndëve që kanë qenë me mjet të jashtëzakonshëm juridik, janë **ndryshuar** 6,06 % nga numri i lëndëve që kanë qenë me mjet të jashtëzakonshëm juridik dhe janë **anuluara** 21,21 % nga numri i lëndëve që kanë qenë me mjet të jashtëzakonshëm juridik.

| Vendime sipas MJJ | Të vërtetuara | | Anuluara | | Të ndryshuara | |
|-------------------|---------------|--------|----------|--------|---------------|-------|
| Numër | Numër | % | Numër | % | Numër | % |
| 132 | 96 | 72,73% | 28 | 21,21% | 8 | 6,06% |

4. PUNA E LËNDËVE NË NIVEL TË SEKTORVE :

A) SEKSIONI PENAL

Në sektorin penal në pajtim me orarin e punës së gjykatësve në Gjykatën e Apelit në Gostivar për vitin 2021, kanë vepruar pesë këshilla penal nga të cilët dy këshilla veprojnë në zgjedhjen e lëndëve të regjistrit "KZH"- lëndë penale të shkallës së dytë dhe nga regjistri "PRKZH" - lëndë për kundërvajtje të shkallës së dytë ndërsa një këshill penal për zgjedhje të lëndëve nga regjistri "KZHM", në pajtim me Ligjin për të Drejtat e të Miturve dhe këshill i posaçëm i cili vepron vetëm me lëndët penale të regjistruara në regjistrin "KSZH" dhe "KR", një këshill penal me pesë gjykatës për vepra penale me të cilat me ligj është përcaktuar dënim me burg në kohëzgjatje deri më 15 vite ose me burg të përjetshëm.

Gjatë vitit 2021 në Seksionin penale kanë vepruar 4 gjykatës përfshirë edhe kryetarin e gjykatës.

Në sektorin penal në periudhën raportuese tërësisht në punë ka pasur 1.512 lëndë nga të cilat 187 lëndë janë përcjellë si të pazgjedhura nga viti i mëparshëm, ndërsa 1.325 lëndë janë lëndë të reja të pranuar, me çka gjykata tërësisht ka zgjedhur 1.331 lëndë, ndërsa në fundin e vitit kanë ngelur të pazgjedhura 181 lëndë që transferohen në vitin e ardhshëm.

Në raport me vitin e mëparshëm kur gjykata në punë ka pasur gjithsej 1.281 lëndë, në periudhën raportuese fushëveprimi i punës është rritur për 231 lëndë, dhe paraqet 1.512 lëndë, dhe kjo ka të bëjë me vëllimin e zmadhuar që është për 112 lëndë më i madh përkundër vitit të kaluar, di dhe për shkak të fluksit të zmadhuar në krahasim me vitin e kaluar për 119 lëndë.

Numri i lëndëve të zgjedhura në periudhën raportuese është rritur për 237 lëndë në krahasim me vitin e kaluar kur ka pasur 1.094 lëndë dhe paraqet 1.331 lëndë. Ndërsa numri i lëndëve të pazgjedhura i cili në vitin 2020 ka qenë 187 lëndë, në këtë vit raportues është zvogëluar për 6 lëndë dhe paraqet gjithsej 181 lëndë.

Në periudhën raportuese në gjykatë në regjistrin “KZH” gjithsej ka pasur 683 lëndë penale që paraqet rritje prej 181 lëndë përkundër vitit 2020. Prej tyre 153 lëndë janë transferuar si të pazgjedhura nga viti i kaluar dhe 530 lëndë të reja janë pranuar, përkatësisht për 84 lëndë më shumë se 2020. Gjithsej ka zgjedhur 505 lëndë, që është për 156 lëndë më pak se viti i kaluar. Në fundin e vitit të pazgjedhura kanë ngelur 178 lëndë, përkatësisht për 25 lëndë më shumë se në vitin 2020.

Në regjistrin “KZHM” lëndë penale në procedurë kundër të miturve, është vërejtur zvogëlim prej 4 lëndëve përkundër vitit të kaluar, në fakt të regjistruara janë 10 lëndë. Bashkë me 2 lëndët që kanë mbetur nga viti i kaluar gjithsej në punë kanë qenë 12 lëndë. Prej tyre janë zgjedhur 10 lëndë dhe 2 lëndë janë bartë si të pazgjedhura për vitin kaluar.

Në regjistrin “KSZH” të regjistruara janë 198 lëndë që paraqet rritje për 49 lëndë krahasuar me vitin 2020. Prej tyre 11 lëndë janë të pa zgjidhura nga viti i kaluar dhe 187 janë lëndë të reja të pranuar, përkatësisht 43 lëndë më shumë se në vitin 2020. Gjykatë periudhës raportuese janë zgjedhur 187 lëndë.

Në regjistrin “PRKZH” lëndë për kundërvajtje janë regjistruar 539 lëndë, përkatësisht 30 lëndë më pak se viti 2020. Duke marrë parasysh edhe 20 lëndë të pazgjidhura nga viti i kaluar, gjithsej në punë ka pasur 559 lëndë nga të cilat në periudhën raportuese janë zgjedhur 558 lëndë, ndërsa 1 lëndë bartet si e pa zgjidhur nga viti i kaluar, që paraqet zvogëlim prej 19 lëndë përkundër vitit kaluar.

Në regjistrin “KP” gjithsej në punë ka pasur 60 lëndë që paraqet rritje prej 20 lëndë krahasuar me vitin e kaluar. Prej tyre 59 lëndë janë lëndë të reja dhe 1 lëndë të bartur si të pazgjidhur nga viti 2020. Në periudhën raportuese janë zgjedhur të gjitha 60 lëndë.

Gjendja në raport me kohëzgjatjen e procedurës është siç vijon:

- **Deri 1 muaj** janë zgjedhur 706 lëndë apo 53,04%;
- **Prej 1-3 muaj** janë zgjedhur 272 lëndë apo 20,44 %;
- **Nga 3-6 muaj** janë zgjedhur 303 lëndë apo 22,76% dhe
- **Mbi 6 muaj** janë zgjedhur 50 lëndë apo 3,76 %.

Punë e lëndëve në nivel të Seksionit Penal

| Regjistri | Lëndë të pambuar a në fillim të vitit | Lëndë të reja të pranuar | Lëndë që janë duke u punuar përsëri | Gabimisht të regjistruara | Gjithsej lëndë në punë | Lëndë të zgjedhura | Lëndë të pazgjedhura |
|------------------|---------------------------------------|--------------------------|-------------------------------------|---------------------------|------------------------|--------------------|----------------------|
| KZH | 153 | 530 | 0 | 0 | 683 | 505 | 178 |
| KZHM | 2 | 10 | 0 | 0 | 12 | 10 | 2 |
| KSZH | 11 | 187 | 0 | 0 | 198 | 198 | 0 |
| PRKZH | 20 | 539 | 0 | 0 | 559 | 558 | 1 |
| KR | 1 | 59 | 0 | 0 | 60 | 60 | 0 |
| GJITHËSEJ | 187 | 1.325 | 0 | 0 | 1.512 | 1.331 | 181 |

B) SEKSIONI CIVIL

Në sektorin civil në pajtim me orarin e punës të gjykatësve dhe të punësuarve të tjerë për vitin 2020 kanë vepruar dy këshilla që veprojnë sipas lëndëve të regjistruara në regjistrin “GZH” - lëndë civile të shkallës së dytë dhe këshilli i tretë, i cili vepron sipas lëndëve të kontesteve tregtare dhe të marrëdhënieve të punës në regjistrin “TSZH” lëndë të shkallës së dytë me konteste tregtare dhe regjistri “ROZH” lëndë nga konteste të marrëdhënieve të punës. Në korniza të sektorit civil ekziston edhe këshill i veçantë që punon me lëndët P5 – vërtetim të përgjegjësive civile për fyerje dhe shpifje, dhe po ashtu ekziston edhe këshill i veçantë që punon lëndët e lidhura me falimentim.

Gjatë vitit 2021, 9 gjyqtarë kanë vepruar në Seksionin Civil.

Në Seksionin Civil në periudhën raportuese në punë ka pasur gjithsej 2.358 lëndë civile, nga të cilat 284 janë transferuar si të pazgjedhura prej vitit të kaluar dhe 2.074 lëndë janë pranuar të reja, me çka Gjykata ka zgjedhur gjithsej 1.876 lëndë, ndërsa në fund të vitit kanë ngelur të pazgjedhura 482 që transferohen në vitin e ardhshëm.

Në lidhje me vitin e mëparshëm, kur Gjykata në punë ka pasur 1.980 lëndë, fluksi i punës në periudhën raportuese është zmadhuar për 387 lëndë dhe gjithsej janë 2.358 lëndë, dhe kjo vjen si rezultat i zmadhimit të fluksit të lëndëve të reja. Përkatësisht përkundër vitit të kaluar kur janë pranuar 1.710 lëndë në vitin 2021 janë pranuar 2.074 lëndë, përkatësisht 364 lëndë më tepër.

Lidhur me lëndët e zgjedhura, në 2020 janë zgjedhur gjithsej 1.696 lëndë, ndërsa në vitin 2021 ky numër është rritur për 180 lëndë dhe paraqet 1.876 lëndë të zgjedhura. Në fund të vitit kanë mbetur të pazgjedhura 482 lëndë, përkatësisht 198 lëndë më shumë se në vitin 2020.

Në regjistrin “GZH” lëndë civile, në punë ka pasur gjithsej 1.366 lëndë, që është rritur për 211 lëndë përkundër vitit të kaluar. Prej tyre 191 lëndë të pazgjedhura nga viti i kaluar dhe 1.175 lëndë të reja të pranuar ë paraqet rritje prej 180 lëndë përkundër vitit 2020. Numri i lëndëve të zgjedhura është 1.079 lëndë apo 115 lëndë më shumë se vitin e kaluar. Gjithashtu ka rritje edhe në mbetjen nga lëndët e pazgjedhura për 96 lëndë dhe paraqet 287 lëndë të pazgjedhura për vitin e ardhshëm.

Në regjistrin “TSZH” konteste tregtare, janë regjistruar 150 lëndë apo 22 lëndë më pak se vitin 2020, pra duke marrë parasysh dhe 39 lëndët e pazgjedhura nga viti i kaluar, gjithsej në punë ka

pasur 189 lëndë. Prej tyre janë zgjedhur 151 lëndë, përkatësisht 12 lëndë më pak se vitin e kaluar, ndërsa të pazgjedhura kanë ngelur edhe 38 lëndë.

Në regjistrin “ROZH” konteste të marrëdhënieve të punës janë regjistruar 724 lëndë, që paraqet rritje prej 202 lëndë krahasuara me vitin e kaluar. Duke marrë parasysh 54 lëndë të pazgjedhura nga viti i kaluar, gjithsej në punë ka pasur 778 lëndë nga të cilat në periudhën raportuese janë zgjedhur 621 lëndë, që paraqet rritje prej 73 lëndëve krahasuar me vitin e kaluar. Si të pazgjedhura kanë mbetur 157 lëndë apo 103 lëndë më tepër se vitin 2020.

Në regjistrin “R” lëndë të ndryshme civile është vërejtur rritje prej 4 lëndë krahasuar me vitin 2020, në fakt janë pranuar 25 lëndë dhe të njëjtat janë zgjedhur, me çka nuk ka mbetje për vitin e ardhshëm.

Këshilli i cili punon në vërtetimin e përgjegjësisë civile për fyerje dhe shpifje në periudhën raportuese ka pasur 15 lëndë, nga të cilët 14 janë zgjidhur në periudhën raportuese, ndërsa 1 lëndë ka mbetur e pa zgjidhur dhe është transferuar për vitin e ardhshëm. Këshilli që punon lëndët lidhur me falimentimin gjithsej në vitin 2021 në punë ka pasur 2 lëndë dhe janë zgjedhur.

Gjendja në raport me kohëzgjatjen e procedurës është siç vijon:

- **Deri 1 muaj** janë zgjedhur 533 lëndë apo 28,41 %,
- **Prej 1-3 muaj** janë zgjedhur 693 lëndë apo 36,94 %,
- **Prej 3-6 muaj** janë zgjedhur 509 lëndë apo 27,13 %,
- **Mbi 6 muaj** janë zgjedhur 141 lëndë apo 7,52 %.

Puna e lëndëve në nivel të Seksionit civil

| Regjistri | Lëndë të pazgjedhura në fillim të vitit | Lëndë të reja të pranuar | Lëndë që punohen sërish | Gabimisht të regjistruara | Gjithsej lëndë në punë | Lëndë të zgjedhura | Lëndë të pazgjedhura |
|-----------------|---|--------------------------|-------------------------|---------------------------|------------------------|--------------------|----------------------|
| GZH | 191 | 1.175 | 0 | 0 | 1.366 | 1.076 | 287 |
| ROZH | 54 | 724 | 0 | 0 | 778 | 621 | 157 |
| TSZH | 39 | 150 | 0 | 0 | 189 | 151 | 38 |
| R | 0 | 25 | 0 | 0 | 25 | 25 | 0 |
| GJITHSEJ | 284 | 2.074 | 0 | 0 | 2.358 | 1.876 | 482 |

5. KUALITETI I LËNDËVE NË NIVEL TË SEKSIONEVE

A) SEKSIONI PENAL

Sektori Penal në Gjykatën e Apelit në Gostivar në periudhën raportuese sipas të dhënave nga lëndët e kthyer nga Gjykata Supreme, ka mbajtur nivelin e lartë të punës.

Gjegjësisht, në periudhën raportuese, gjithsej janë kthyer 34 vendime për lëndë penale. Nga këto, 28 vendime janë **aprovuar**, përkatësisht 2,10 % nga lëndët e zgjidhura, 5 vendime janë revokuar, d.m.th 0,38 % nga gjithsej lëndët e zgjidhura dhe 1 vendim është ndryshuar përkatësisht 0,08 % nga numri i përgjithshëm i lëndëve të zgjidhura këtë në seksion.

- Në regjistrin “KZH” janë aprovuar 25 vendime, apo 4,95 % nga numri lëndëve të zgjidhura, 5 vendime janë abroguar apo 0,99 % nga numri i lëndëve në përgjithësi dhe 1 vendim është ndryshuar, përkatësisht 0,20 % nga numri i përgjithshëm i lëndëve të zgjedhura.

- Në regjistrin “KSZH” janë kthyer 3 vendime të gjitha janë aprovuar përkatësisht 1,52 % nga numri i lëndëve në këtë regjistrë.

| Regjistri | Lëndë të zgjidhura | Të vërtetuara | | Abrogua | | Të ndryshuara | |
|------------------|--------------------|---------------|---------------|----------|--------------|---------------|---------------|
| KZH | 505 | 25 | 4,95 % | 5 | 0,99 % | 1 | 0,20 % |
| KZHM | 10 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| KSZH | 198 | 3 | 1,52 % | 0 | 0 | 0 | 0 |
| PRKZH | 558 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| GJITHËSEJ | 1.331 | 28 | 2,10 % | 5 | 0,38% | 1 | 0,08 % |

Sa i përket 34 vendimeve të kthyer nga Gjykata Supreme, janë **aprovuar** 82,35% e numrit të lëndëve që kanë qenë pas mjetit të jashtëzakonshëm juridik, 14,71% e numrit të lëndëve që kanë qenë pas mjetit të jashtëzakonshëm juridik janë shfuqizuar dhe 2,94% janë **ndryshuar** nga numri i lëndëve që ishin pas një mjeti të jashtëzakonshëm juridik.

Në regjistrin “KZH” nga gjithsej 31 vendime janë **vërtetuar** 25 vendime, përkatësisht 80,65% e numrit të lëndëve që kanë qenë pas mjetit të jashtëzakonshëm juridik, janë **revokuar** 5 vendime, përkatësisht 16,13% e numrit të lëndëve që kanë qenë, pas mjetit të jashtëzakonshëm juridik dhe është **ndryshuar** 1 vendim, përkatësisht 3,23% e numrit të rasteve që kanë qenë pas mjetit të jashtëzakonshëm juridik.

Në regjistrin “KSZH” nga 3 vendimet e kthyer janë të vërtetuara të gjitha, pra 100% e numrit të lëndëve që kanë qenë pas mjetit të jashtëzakonshëm juridik.

| Regjistri | Vendime sipas MJJ | Të vërtetuara | | Të abrogaura | | Të ndryshme | |
|-----------------|-------------------|---------------|----------------|--------------|----------------|-------------|---------------|
| KZH | 31 | 25 | 80,65 % | 5 | 16,13 % | 1 | 3,23 % |
| KZHM | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| KSZH | 3 | 3 | 100 % | 0 | 0 | 0 | 0 |
| PRKZH | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Gjithsej | 34 | 28 | 82,35 % | 5 | 14,71 % | 1 | 2,94 % |

B) SEKSIONI CIVIL

Seksioni Civil në Gjykatën e Apelit në Gostivar në periudhën raportuese sipas të dhënave nga lëndët e kthyera nga Gjykata Supreme, ka mbajtur nivelin e lartë të punës.

Gjegjësisht, në periudhën raportuese nga Gjykata Supreme janë kthyer gjithsej 98 vendime, prej tyre janë aprovuar 68 vendime, d.m.th 3, 62 % të lëndëve të zgjidhura, 7 vendime janë ndryshuar, d.m.th 0,37 % të lëndëve të zgjidhura dhe 23 vendime janë ndryshuar d.m.th 1,23 % nga lëndët e zgjidhura totale në këtë seksion.

■ Në regjistrin “GZH” janë aprovuar 44 lëndë apo 4,08 % nga numri i lëndëve, 4 vendime janë ndryshuar apo 0,37 % nga numri i lëndëve dhe 16 vendime janë anuluar apo 1,48 % nga numri i lëndëve në këtë regjistër.

■ Në regjistrin “TSZH” 12 vendime janë aprovuar apo 7,95 % nga numri i lëndëve, 1 vendim është ndryshuar apo 0,66 % nga numri i lëndëve dhe 5 vendime janë abroguar gjegjësisht 3, 31 % nga gjithsej lëndë të zgjedhura.

● Në regjistrin “ROZH” 12 vendime janë aprovuar apo 1,93 % nga numri i lëndëve, 2 vendime janë ndryshuar apo 0,32 % nga numri i lëndëve dhe 2 vendime janë anuluar apo 0,32 % nga numri i lëndëve të zgjedhura në këtë regjistër.

| Regjistri | Lëndë të zgjidhura | Të vërtetuara | | Të ndryshuar | | Të anuluar | |
|-----------------|--------------------|---------------|--------------|--------------|--------------|------------|--------------|
| GZH | 1.079 | 44 | 4,08% | 4 | 0,37% | 16 | 1,48 % |
| TSZH | 151 | 12 | 7,95% | 1 | 0,66 | 5 | 3,31% |
| ROZH | 621 | 12 | 1,93% | 2 | 0,32% | 2 | 0,32% |
| R | 25 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| GJITËSEJ | 1.876 | 68 | 3,62% | 7 | 0,37% | 23 | 1,23% |

Sa i përket 98 vendimeve të kthyera nga Gjykata Supreme, 69,39% e numrit të lëndëve që ishin pas mjetit të jashtëzakonshëm juridik janë vërtetuar, 23,47% e numrit të lëndëve që ishin pas mjetit të jashtëzakonshëm juridik janë shfuqizuar dhe 7,14% janë ndryshuar nga numri i rasteve që ishin pas një mjeti të jashtëzakonshëm juridik.

■ Në regjistrin “GZH” nga 64 vendimet e kthyera janë vërtetuar 44 lëndë, gjegjësisht 68,75% e numrit të lëndëve që kanë qenë pas mjetit të jashtëzakonshëm juridik, janë ndryshuar 4 vendime, përkatësisht 6,25% e numrit të lëndëve që kanë qenë pas mjetit të jashtëzakonshëm juridik dhe janë revokuar 16 vendime, përkatësisht 25% e numrit të lëndëve që kanë qenë në mjet të jashtëzakonshëm juridik.

■ Në regjistrin “TSZH” nga 18 vendimet e kthyera janë vërtetuar 12 vendime, gjegjësisht 66,67% e numrit të lëndëve që kanë qenë pas mjetit të jashtëzakonshëm juridik, 1 vendim është ndryshuar, pra 5,56% e numrit të lëndëve që kanë qenë pas mjetit të jashtëzakonshëm juridik dhe janë revokuar 5 vendime, përkatësisht 27,77% e numrit të lëndëve që kanë qenë në mjet të jashtëzakonshëm juridik.

■ Në regjistrin “ROZH” nga 16 vendimet e kthyera janë vërtetuar 12 vendime, përkatësisht 75% e numrit të lëndëve që kanë qenë në mjet të jashtëzakonshëm juridik, janë ndryshuar 2 vendime, përkatësisht 12,5% e numrit të lëndëve që kanë qenë pas mjetit të jashtëzakonshëm juridik dhe 2 vendime janë revokuar, pra 12,5% e numrit të rasteve që kanë qenë pas mjetit të jashtëzakonshëm juridik.

| Regjistri | Vendime sipas MJJ | Të vërtetuara | | Të ndryshuara | | Të anuluar | |
|------------------|-------------------|---------------|---------------|---------------|--------------|------------|---------------|
| | | | | | | | |
| GZH | 64 | 44 | 68,75% | 4 | 6,25% | 16 | 25% |
| TSZH | 18 | 12 | 66,67% | 1 | 5,56 % | 5 | 27,77% |
| ROZH | 16 | 12 | 75% | 2 | 12,5% | 2 | 12,5% |
| R | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| GJITHËSEJ | 98 | 68 | 69,39% | 7 | 7,14% | 23 | 23,47% |

6. GJENDJA E LËNDËVE TË VJETRA

Si lëndë të vjetra në këtë periudhë raportuese, në punë ka pasur 187 lëndë nga të cilat 12 janë transferuar si lëndë të vjetra të pazgjidhura nga viti i mëparshëm dhe 175 lëndë që janë pranuar të reja, gjegjësisht i'u ka kaluar periudha 6 mujore nga dita e pranimit të lëndës në Gjykatë. Nga to janë zgjidhur 166 lëndë, ndërsa në fund të vitit kanë ngelur 21 të pazgjidhura të cilat transferohen në vitin tjetër. fund të vitit kishin mbetur 12 lëndë, nga të cilat 7 lëndë "KZH" të gjitha nga viti 2020, 3 lëndë "GZH" - dy nga 2020 dhe 1 nga 2019 dhe 2 lëndë "ROZH" nga viti 2020.

| Regjistri | Lëndë të vjetra të pazgjidhura | Lëndë të reja të pranuar nga të vjetrat | Gjithsej në punë lëndë të vjetra | Lëndë të vjetra të zgjidhura | Mbetja e lëndëve të vjetra |
|-----------------|--------------------------------|---|----------------------------------|------------------------------|----------------------------|
| KZH | 7 | 41 | 48 | 41 | 7 |
| KSZH | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| PRKZH | 0 | 4 | 4 | 4 | 0 |
| GZH | 3 | 99 | 102 | 92 | 10 |
| ROZH | 2 | 7 | 9 | 7 | 2 |
| TSZH | 0 | 24 | 24 | 22 | 2 |
| Gjithsej | 12 | 175 | 187 | 166 | 21 |

7. RAPORTI MBI RESURSET NJERËZORE

Në pajtim me Vendimin e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë nr. 07-1103 / 1 të datës 04.06.2012, funksioni gjyqësor në Gjykatën e Apelit Gostivar u përcaktua të kryhet nga 16 gjyqtarë, përfshirë Kryetarin e Gjykatës, megjithatë, gjatë vitit raportues, Gjykata funksionoi në një përbërje jo të plotë të gjyqtarëve, me atë që funksionin gjyqësor e kryejnë 11 gjyqtarë, përfshirë edhe Kryetarin e gjykatës.

Sipas raportit për vitin 2021, Gjykata e Apelit Gostivar pati problem me mungesën e gjykatësve, nga kjo arsye gjykata nuk ishte efikase dhe i azhurnuar në përballjen me fluksin e lëndëve në muaj të caktuar, në varësi të fluksit të lëndëve të reja të pranuar. Ky jo efikasitet dhe jo azhurnim i gjykatës pritet të thellohet, përderisa nuk merren masa për zgjidhjen e gjykatësve të rinj, me qëllim që puna e gjykatës të jetë më e mirë dhe me funksion më të suksesshëm.

ADMINISTRATA GJYQËSORE

Gjatë vitit raportues, nëpunësit e gjyqësor profesional kanë një kontribut të veçantë në funksionimin e gjykatës përmes kryerjes profesionale dhe të ndërgjegjshme të detyrave të punës, në lidhje me përgatitjen e vendimeve gjyqësore dhe më shumë.

Sipas Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Gjykatën e Apelit Gostivar, puna në shërbimin gjyqësor sigurohet të kryhet nga staf profesional, ndihmës dhe administrativo-teknik, si më poshtë: nëpunës gjykate 110 kryerës, staf teknik të punësuar nga 10 kryerës sipas LMP dhe në lidhje me çështjet e policisë gjyqësore, 8 kryerës, d.m.th gjithsej janë parashikuar 128 kryerës.

Lidhur me plotësimin e vendeve të lira të punës sipas Sistematizimit të kësaj gjykate, deri në fund të vitit raportues, gjegjësisht deri më 31.12.2021 detyrat ishin kryer nga 32 nëpunës gjykate, 2 pastrues dhe 1 shofer, 1 pjesëtar i policisë gjyqësore, ndërsa vendet e lira sipas Sistematizimit janë 91 kryerës.

Gjatë vitit 2021 Gjykata e Apelit Gostivar ka realizuar pesë punësime të reja përmes shpalljes publike dhe atë: 2 pastrues, 1 referent i ri i pavarur – kontabilist, 1 referent gjyqësor – daktilograf dhe 1 pjesëmarrës të policisë gjyqësore dhe një punësim i ri bashkëpunëtor i ri gjyqësor me marrje nga k-5 programi nga Ministria e Sistemit Politik dhe raporteve në mes komuniteteve në RMV-së.

Duke marrë parasysh se, një nëpunës gjykate është në pushim për shkak të zhvillimit profesional deri më 11.02.2022, dhe në vitin 2021 janë liruar tre vende të lira pune dhe atë: një Këshilltar inxhinier informatike (me pajtim), një referent i pavarur – kontabilist (me marrje nga gjykata themelore Dibër) dhe një pastrues (me marrje nga gjykata themelore Gostivar).

Në fund të vitit raportues, Gjykata ka përbërjen vijuese, si më poshtë: 1 udhëheqës i administratës, 1 udhëheqës i sektorit të informatikës, 7 bashkëpunëtor gjyqësor, 6 bashkëpunëtor të rinj gjyqësor, 2 bashkëpunëtor – përkthyes/interpretues, 1 bashkëpunëtor i ri – ekonomist, 1 referent i pavarur kontabilist, 1 referent i pavarur në sektorin e informatikës, 1 referent i lartë në sekretarinë e sektorit penal, 1 referent i ri gjyqësor në sekretarinë e sektorit civil, 1 referent i lartë gjyqësor në arshivën gjyqësore, 6 referent gjyqësor – daktilograf, 1 vozitës, 2 pastrues dhe 1 pjesëtar i policisë gjyqësore.

Gjykata e Apelit Gostivar, në mënyrë që të arrijë efikasitet maksimal në punë në të gjitha seksionet dhe fushat, pra të kryejë të gjitha detyrat dhe qëllimet e punës brenda kompetencave të saj me cilësi dhe profesionalizëm, ka nevojë për punësime të reja të stafit profesional, si dhe stafit administrativo-teknik dhe anëtarë të policisë gjyqësore.

8. RAPORTI MBI HARMONIZIMIN E PRAKTIKËS GJYQËSORE

Në pajtim me autorizimet e parapara në rregulloren gjyqësore ('Gazeta Zyrtare e RM', nr. 66/2013) sektori i praktikës gjyqësore, sjell plan vjetor për punë në sektorin e praktikës gjyqësore në Gjykatë e Apelit Gostivar për vitin 2021.

Gjatë viti 2021, sektori për praktikë gjyqësore me efikasitet i ka kryer punët në përgjegjësi, ka mbajtur dy mbledhje pune në sektorin civil dhe një mbledhje në sektorin penal, ku janë sjellë përfundime të disa pyetjeve të caktuara. Gjithashtu në muajin tetor është organizuar edhe tryezë e rrumbullakët në nivel të katër Gjykatave të Apelit në RMV, të organizuara nga ana e Akademisë për gjykatës dhe prokuror publik të RMV ku edhe janë sjellë përfundimet.

9. RAPORTI PËR VIZITAT E KRYERA TË GJYKATAVE MË TË ULTA

Në bazë të metodologjisë për kryerjen e vizitave të punës në gjykatat themelore nga rajoni i Gjykatës së Apelit Gostivar dhe orarin e caktuar për vizitat e punës në gjykatat themelore të rajonit të këtij apeli për vitin 2021, Gjykata e Apelit Gostivar në pajtim me vendimet dhe propozimet e Qeverisë së RMV, të cilat i takojnë të marrjes së masave mbrojtëse me qëllim të zvogëlimit të rrezikut nga përhapja e pandemisë KOVID-19, realizoi vetëm një vizitë pune në muajin Shtator dhe Tetor në vitin 2021.

10. RAPORTI PËR MARRËDHËNIE ME PUBLIKUN

Në pajtim me nenin 4 dhe nenin 12 nga Ligji për qasje të lirë të informacionit nga natyra publike ('Gazeta Zyrtare e RM, nr. 13.06, nr. 86/08, nr. 6/10, nr. 42/14, nr. 148/15, nr. 55/16, nr. 64/18), personat fizik dhe juridik të huaj dhe të vendit kanë të drejtë të qasjes së lirë të informacionit nga natyra publike, që janë rreth punës së gjykatës.

Në vitin raportues 2021, në pajtim me ligjin e lartpërmendur, deri te kjo gjykatë janë dorëzuar gjithsej 7 (shtatë) kërkesa, të cilat në afatin e paraparë ligjor pozitivisht janë përgjigjur.

Kundër procesverbaleve të sjella nga kjo gjykatë, me të cilat është përgjigjur në informacionet e kërkuara të natyrës publike, nuk është parashtruar asnjë ankesë deri te Komisioni për mbrojtjen e të drejtës së qasjes së lirë të informacionit nga natyra publike.

Në zyrën për marrëdhënie me publikun në periudhën raportuese nuk janë dorëzuar kërkesa në lidhje me vendimet e publikuara në web faqen e gjykatës.

Në periudhën raportuese janë publikuar 3.199 vendime të anonimizuara.

Gjykata e Apelit Gostivar si pjesë e sistemit gjyqësor të RMV-së, me rastin e 25 Tetorit 'Dita ndërkombëtare e drejtësisë, çdo vit aktivisht merr pjesë në shënimin e kësaj dite. Këtë vit ishin prezent student nga Fakulteti Juridik pranë Universitetit Ndërkombëtar – Struga me seli në Gostivar, bashkë me profesorët e Fakultetit Juridik, si dhe mediumet lokale dhe atë TV2, TV Globi dhe gazeta ditore Gostivar Press. Në shënimin e ditës u paraqitën aktivitete të kësaj gjykate me qëllim që qytetarët të jenë të njoftuar me të drejtat e tyre themelore në më shumë lëmi (qasja deri te drejtësia, meditacioni, kryerja e aktgjykimeve gjyqësore dhe të ngjashme).

11. RAPORTI MBI TEKNOLOGJINË INFORMATIVE

Funksionimi i gjyqit në periudhën raportuese në aspektin e teknologjisë informative u zhvillua pa pengesa, si dhe në pjesën e përdorimit të Sistemit informatikë automatik për menaxhimin e lëndëve gjyqësore (AKMIS).

Sistemi AKMIS nga ana e të punësuarve përdoret plotësisht në të gjitha segmentet e punës. Çdo lëndë gjegjësisht çdo akt rregullisht regjistrohet në dosjet elektronike të lëndëve dhe përpunohen në përputhje me rrethanat. Të gjitha raportet e duhura mujore, tre mujore dhe vjetore përpunohen në mënyrë elektronike. Të njëjtat njëkohësisht dorëzohen deri te institucionet përkatëse dhe publikohen në web faqen tonë.

Në gjykatë ka sallë gjykimi ku është instaluar pajisje për regjistrim të tonit të zërit gjatë seancave në pajtim me Ligjin për Procedure Kontestuese. E njëjta pajisje rregullisht përdoret nga ana e gjykatësve nga sektori civil, tregtar dhe sektori për marrëdhëniet e punës duke ndjekur rregullat për regjistrim të tonit të zërit. Por, duke marrë parasysh domethënien e këtij sistemi dhe përdorimin

e suksesshëm në të ardhmen duhet të sigurohet mirëmbajtje dhe përmirësim i sistemit për shkak të pasjeve tashmë të konsumuara.

Në lidhje me dërgesat ekelektronike, në këtë periudhë raportuese nuk janë paraqitur probleme dhe procedura e dërgesave elektronike po kryhet pa pengesa, vetëm drejt atyre avokatëve që janë regjistruar në portalin e dërgesave elektronike. Gjatë viti 2021 është kryer dërgesë elektronike të gjithsej 64 dërgesave.

Në gjykatë rregullisht bëhet skenimi i të gjitha shtojcave në lidhje me lëndët gjyqësore që janë dorëzuar direkt në gjykatë dhe të njëjtat bashkëngjiten në dosjen elektronike të lëndëve në AKMIS. Në vitin 2021 janë skanuar gjithsej 257 shtojca, që janë dorëzuar në sektorin e duhur.

Anonimizimi i vendimeve të Gjykatës po kryhet pa pengesa dhe në periudhën raportuese janë publikuar gjithsej 3.199 vendime anonime. Gjithashtu web portali i Gjykatës rregullisht përditësohet me raporte mujore, tre mujore dhe vjetore, si dhe me të gjitha informacionet e duhura për palët. Gjykata e Apelit Gostivar gjithashtu ndjek punën e Gjykatave Themelore në rajonin që mbulon në lidhje me dërgesat elektronike, regjistrimin e tonit të zërit dhe procesin e anonimitetit dhe publikimit të vendimeve në baza javore.

Sa i përket harduerit të gjithë kompjuterët janë të mbrojtur nga një antivirus i licencuar. Përgjatë vitit 2021 është bërë furnizim i 11 kompjuterëve, por gjykata akoma ka nevojë për furnizim të mjeteve të reja, si në aspektin e kompjuterëve personal ashtu edhe në aspektin e printerëve në rrjet.

Probleme të caktuara në punë janë shkaktuar nga instalimi i vjetër i rrjetit në Gjykatë, i cili është instaluar që nga viti 2010 dhe kapaciteti i të cilit nuk i plotëson nevojat për funksionim normal dhe është i nevojshëm zëvendësimi i tij.

Nga formimi i gjykatës përdoret serveri i përhershëm, që mbulon punën e çdo sistemi kompjuterik. Mbingarkesa dhe harxhimi i të njëjtit, ndjehet në punën e përditshme që sjell deri te ngadalësimi i punës. Në kuptim të kapacitetit të harduerit nuk i kënaq nevojat e gjykatës, por me prokurimin e serverëve të rinj e cila është në procedurë, ky problem do të kalohet.

Gjykata edhe këtë vit rinovoi certifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015, me çka krijon, dokumenton, implementon dhe mirëmban sistemin me përmirësimin e tij të vazhdueshëm.

Puna me sistemin ABMS kryhet pa pengesa, përmirësohet në kohën e duhur dhe përgjatë periudhës raportuese nuk janë paraqitur probleme.

Gjithashtu rritja dhe modifikimi i teknologjisë informative kërkon që të gjithë të punësuarit në gjykatë të përmirësohen dhe perfeksionohen për mënyrën përdorimit të tij.

12. RAPORTI MBI PAISJE DHE MIRËMBAJTJEN E NDËRTESËS SË GJYKATË

Ndërtesa e Gjykatës së Apelit Gostivar gjendet me lokacion në rrugën 'Zhivko Brajkovski' nr. 1 Gostivar.

Hapësirat e punës së Gjykatës së Apelit Gostivar janë në katin e tretë të objektit, në dispozicion ka 27 zyra, një sallë gjyqi, dy magazinë dhe një sallë të serverit.

Hapësirat e punës janë të furnizuara me mjete bazë dhe mobilim të vogël, ndërtesa ka sistem qendror të nxehjes dhe ftohjes, ndërsa mjetet janë të arkivuara në ormar të hekurt që janë vendosur në korridore.

Gjendja e sigurisë së objektit është i kënaqshëm, në të njëjtin objekt janë të vendosura edhe Gjykata Themelore, Prokuroria e Lartë Publike, Prokuroria Themelore Publike dhe Avokati Shtetëror Gostivar.

13. RAPORTI MBI PROKURIMET E PLANIFIKUARA DHE TË KRYERA

Gjatë vitit raportues 2021, Gjykata e Apelit Gostivar punoi në realizimin e prokurimeve të cilat ishin në korniza të Planin Vjetor të paraparë për prokurime publike për vitin 2021. Pjesa më e madhe e prokurimeve gjatë vitit janë rezultat i prokurimeve të rregullta vjetore të cilat zbatohen çdo vit për nevojat e gjykatës, gjithashtu Kryetari i Gjykatës u angazhua për realizimin e disa procedurave për prokurim publik të mallit, shërbimeve dhe punëve, përmes sistemit për prokurime publike, dhe atë:

- PROKURIM I MOBILJEVE TË VOGLA DHE MJETEVE PËR MIRËMBAJTJE TË HIGJENËS;
- PROKURIM I KOMPJUTERËVE TË RINJ;
- PROKURIM I MATERIALEVE PËR AOP TONER DHE PRINTER;
- PROKURIM I MATERIALEVE PËR ZYRA;
- PROKURIM NË GRUP TË SHËRBIMEVE TË INTERNETIT;
- PROKURIME NË GRUP TË SHËRBIMEVE TË POSTËS SË MAQEDONISË;
- PROKURIM NË GRUP TË LETRAVE PËR KOPJIM DHE PRINTIM;
- PROKURIM TË SHËRBIMEVE PËR SHFRYTËSIMIN E TELEFONIT FIKS;
- PROKURIM NË GRUP I SHËRBIMEVE TË SHFRYTËZIMIT TË LINJËS TELEFONIKE;
- PROKURIM I FURNIZIMIT TË GJYKATËS SË APELIT GOSTIVAR ME ÇERTEFIKATË PËR SISTEMIN E ADMINISTRIMIT ME KUALITET ISO 9001: 2015;
- REKONSTRUIM I QENDRËS TELEFONIKE;
- MIRËMBAJTJE E HAPËSIRAVE TË GJYKATËS.

TË GJITHA PROKURIMET JANË REALIZUAR NË TËRËSI DHE NË KOHË TË CAKTUAR, DHE DINAMIKA E VËRTETUAR MË PARË NGA ANA E PERSONAVE PËRGJEGJËS PËR KRYERJEN E PROKURIMEVE TË MJETEVE, NË PAJTIM ME NEVOJAT E KOHËS TË GJYKATËS.

Претседател на
Апелационен суд Гостивар
Bekim Mehmedi



Gostivar, Shkurt 2022